



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 216

Tiranë – E hënë, 23 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 18.12.2024	Për lirim nga detyra..... 24855
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 778, datë 18.12.2024	Për emërim në detyrë..... 24855
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 18.12.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 24855
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 18.12.2024	Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike..... 24866
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 783, datë 18.12.2024	Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike..... 24868
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 18.12.2024	Për përcaktimin e rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale..... 24871
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 785, datë 18.12.2024	Për miratimin e ndërtimit të termocentralit dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Roskovec, qarku Fier, nga shoqëria “Fier Thermoelectric”, sh.a..... 24872
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 18.12.2024	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në komandën e NATO-s në <i>Wiesbaden</i> , Gjermani, për ndihmë dhe trajnim për Ukrainën..... 24874
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 18.12.2024	Për deklarimin “Pasuri kulturore e paluajtshme” të zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Shkodrës, miratimin e zonifikimit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre..... 24874

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 18.12.2024	Për deklarinimin “Pasuri kulturore e paluajtshme” të zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Vlorës, miratimin e zonifikimit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.....	24880
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 18.12.2024	Për deklarinimin “Pasuri kulturore” të zonës arkeologjike nënujore A të vendbanimit Palafit të fshatit Lin në Pogradec, miratimin e zonifikimit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e kësaj zone.....	24886
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 307, datë 10.12.2024	Për miratimin e rregullores “Për regjistrimin e personave që lundrojnë në bordin e anijeve të pasagjerëve që operojnë drejt ose nga portet e Republikës së Shqipërisë.....	24889
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 122, datë 27. 11.2024	Autorizim i ndihmës shtetërore “Grante për <i>start up</i> -et dhe lehtësuesit e <i>start up</i> -eve për vitin 2025”	24893
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 240, datë 14.11.2024	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	24895
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 242, datë 14.11.2024	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit për kërkesën e shoqërisë “Rebesol” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike	24897
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 243, datë 14.11.2024	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit për kërkesën e shoqërisë “Samasol” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike	24898
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 244, datë 14.11.2024	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit për kërkesën e shoqërisë “Zenina” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	24900
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 245, datë 14.11.2024	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit për kërkesën e shoqërisë “Driben” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	24901
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 1052/9, datë 17.12.2024	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 414, datë 27.5.2020, për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga projekti, ‘Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës’”.....	24902

**VENDIM****Nr. 777, datë 18.12.2024****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Nina Guga, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM**Nr. 778, datë 18.12.2024****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Orjana Osmani emërohet zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM**Nr. 781, datë 18.12.2024**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 359, DATË 5.6.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e pronave me vendndodhje në bashkitë Tiranë, Himarë, Fier dhe Sarandë, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët dhe plan-rilevimet, me emërtimet “Administratë, Tiranë”, “Administratë, Sarandë”, “Shërbimi Informativ i Shtetit, Fier”, “Qendër Trajnimi dhe Kualifikimi, Himarë” dhe “Qendër Trajnimi dhe Kualifikimi, Himarë 2”, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Lista përbëhet nga 5 (pesë) fletë formulari dhe 5 (pesë) plan-rilevime, që janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në pronën me nr. 955, me emërtimin “Ish-Brigadë Këmbësorie”, hiqen komponentët me emërtimin “Objekti nr. 4, Ish-



komanda 2 kt” dhe “Objekti nr. 5 ‘Ish-depo’”, së bashku me truallin funksional, sipas plan-rilevimit për pasurinë nr. 1/1135, zona kadastrale 1952, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Shërbimi Informativ i Shtetit, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

Institucioni Qendror Shtetëror, Shërbimi Informativ i Shtetit Tirane Supervizor: Armando Goxha (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Aprovat: Vlora Hyshaj, DREKTOR (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)												
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hantes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m ²)	Sip. e truallit (m ²)		Funksionet dhe përdorimi pronës/pasurisë	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
						Truall	Ndërtim					
1	8130 TR-K-15 TR-J-15	2/46	Truall	Administrative Tirane	26882.11	26882.11		Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit Tirane	VKM 359, datë 5.6.2003	
			Ndërtesë	Godina nr.1			457.12	Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit		4 kate
			Ndërtesë	Godina nr.6			309.42	Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit		1 kat.
			Ndërtesë	Godina nr.3			1307.44	Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit		2 kate
			Ndërtesë	Godina nr.8			152.93	Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit		1 kat.
			Ndërtesë	Godina nr.7			1336.5	Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit		1 kat.
			Ndërtesë	Godina nr.2			935.86	Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit		4 kate
			Ndërtesë	Godina nr.5			982.79	Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit		2 kate
			Ndërtesë	Godina nr.4			1516.98	Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit		2 kate
			Ndërtesë	Godina nr.9			33.53	Administrative	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit		1 kat.



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE					
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË		DATE: 01.11.2023		QELIMI: PERDITESIM/REGJISTRIM	
VENDNDODHJA BASHKIA: TIRANE		DVASHK/ZVASHK: TIRANA VERI		ZONA KADASTRALE: 8130	
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: TRUALL		SIP.PASURISE = 26694.2 m2		NUMRI PASURISE: 2/46	
		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT = 6933 m2		INDEX HARTE: TR-K-15, TR-J-15	
				NUMRI KATEVE: _____	
				NUMRI PEMEVE: _____	

X 486196
Y 4578594

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 486480
Y 4578594

SH 1:1500

X 486196
Y 4578277

X 486480
Y 4578277

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1						
2						
3						
4						

REALIZOI PER ASHK
SPECIALISTI _____
DVASHK _____ Anida
NENSHKRIMI _____ Shehu
KONFIRMOI
PERGJEGJESI/DREJTORI _____
NENSHKRIMI / VULA _____

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT
EMRI: _____
LICENCA: NR. _____ DATE _____
KOMPANIA: _____
NIPT: _____
NENSHKRIMI/VULA _____


TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O, M
PERCAKTIMI KUFIRIT: P, HK
SHENIME TE VECANTA:
PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET
EMRI _____
NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; R-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



Nr. Rend	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasuse	Lloji i Pronas	Emërtasë e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funkcioni për të cilin pendoret pronar/pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronasi	Institucioni perdorues i pasurisë Status juridik i perdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënimet të veçanta)
						Tërhiqje (m2)	Ndërtim (m2)					
1	8641 SR; D-8+C14.N17	19/343	Tërhiqje	Administrative Sarandë	624.66	184.25		Administrative	Shërbimi Informativ i Shetit	Shërbimi Informativ i Shetit	VKM 359, datë 5.6.2003	3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë
		Pjesë e Pas. 19/108	Tërhiqje		27.43			Administrative	Shërbimi Informativ i Shetit	Shërbimi Informativ i Shetit		
		Pjesë e Pas. 19/430	Indular		23.3			Administrative	Shërbimi Informativ i Shetit	Shërbimi Informativ i Shetit		
		Pjesë e Pas. 19/359	Tërhiqje		3.3			Administrative	Shërbimi Informativ i Shetit	Shërbimi Informativ i Shetit		



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE: 14.02.2024		QELIMI: PERDITESIM/REGJISTRIM																																				
VENDNDODHJA																																								
BASHKIA: SARANDE DVASHK/ZVASHK: SARANDE ZONA KADASTRALE: 8641 NUMRI PASURISE: 19/343,19/359,19/430,19/108 INDEX HARTE: SR; D-8																																								
TE DHENAT E PASURISE																																								
LLOJI PASURISE: TRUALL+TROUAR SIP.PASURISE = 2072.84 m2 SIPERFAQE GJURMES NDETIMIT = 189.25 m2 NUMRI KATEVE: NUMRI PEMEVE:																																								
X 500097 Y 4415959		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE		X 500194 Y 4415959																																				
 SHPJEGUES KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE — SIPERFAQE = 678.69 m2 NDERTESA SIPAS GJENDJES FAKTIKE — SIPERFAQE = 184.25 m2 KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE — SIPERFAQE = 641.42 m2 SH 1:500 																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"><thead><tr><th>Nr.</th><th>ORIENTIMI</th><th>PERDORIMI</th><th>TIPI KUFIRIT</th><th>KUFITARI</th><th>ID/NIPT</th><th>SHENIME TE REALIZUESIT</th></tr></thead><tbody><tr><td>1</td><td>VERI</td><td></td><td></td><td>19/359</td><td></td><td></td></tr><tr><td>2</td><td>LINDJE</td><td></td><td></td><td>19/359</td><td></td><td></td></tr><tr><td>3</td><td>JUG</td><td></td><td></td><td>19/430</td><td></td><td></td></tr><tr><td>4</td><td>PERENDIM</td><td></td><td></td><td>19/108</td><td></td><td></td></tr></tbody></table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI			19/359			2	LINDJE			19/359			3	JUG			19/430			4	PERENDIM			19/108		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI			19/359																																				
2	LINDJE			19/359																																				
3	JUG			19/430																																				
4	PERENDIM			19/108																																				
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: _____ LICENCA: NR. _____ DATE _____ KOMPANIA: _____ NIPT: _____ NENSHKRIMI/VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____																																					
REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ NENSHKRIMI _____			PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET																																					
KONFIRMOI <u>Eugen</u> PERGJEGJESI/DREJTORI NENSHKRIMI / VULA _____			EMRI _____ NENSHKRIMI _____																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								




Institucioni Qendror Shtetesor: Sherbimi Informativ i Shtetit Fier											
Nr. Rend	Zona Kadast. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Promes	Emertesa e pasurise Adresa	Sip e pasurise (m2)	Institucioni		Institucioni perdorues i pasurise Statusi juridik i perdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhene te tjera (Shenime te vecanta)	
						Truall (m2)	Norma				
						Institucioni					
						Institucioni					
						Institucioni					
1	8534	2/148	Truall	Sherbimi Informativ i Shtetit Fier	825.22			Sherbimi Informativ i Shtetit	VKM 359, date 5.6.2003		
			Ndertese	ND1		194.96	Sherbimi Informativ i Shtetit	Sherbimi Informativ i Shtetit		3 kate	
			Ndertese	ND2		40.43	Sherbimi Informativ i Shtetit	Sherbimi Informativ i Shtetit		1 kat	
			Ndertese	ND3		99.97	Sherbimi Informativ i Shtetit	Sherbimi Informativ i Shtetit		1 kat	
			Ndertese	ND4		6.9	Sherbimi Informativ i Shtetit	Sherbimi Informativ i Shtetit		1 kat	

Ioana Kaposh
(emri i shtetit, pozicioni zyrtar)
Armenia Goxha
(emri i shtetit, pozicioni zyrtar)
Vlora Haxhiu
(emri i shtetit, pozicioni zyrtar, let. firma vula)

Supervizor
Drejtor


REPUBLICA E SHQIPERISE



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHERBIMI INFORMATIV KOMBETAR		DATE: 12.02.2024		QELIMI: PERDITESIM/REGJISTRIM																																				
VENDNDODHJA																																								
BASHKIA: FIER		DVASHK/ZVASHK: FIER		ZONA KADASTRALE: 8534																																				
TE DHENAT E PASURISE		NUMRI PASURISE: 2/148		INDEX HARTE: FR; L-5, K-5																																				
LLOJI PASURISE: TRUALL		SIP.PASURISE = 825 m2		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT = 321.6 m2																																				
NUMRI KATEVE		NUMRI PEMEVE		NUMRI PEMEVE																																				
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X 462263		Y 4510374		X 462361																																				
Y 4510374		Y 4510374		Y 4510374																																				
SH 1:500																																								
 SHPJEGUES KUFIRI PASURISE QE KERKOHET PER PERDITESIM VKM SIPERFAQE = 825.22 m2 SIP. E GJURMES SE NDERTIMIT = 342.26 m2 SIP. N1 = 194.96 m2, SIP.N2 = 40.43 m2 SIP. N3 = 99.97 m2, SIP.N4 = 6.90 m2																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"><thead><tr><th>Nr.</th><th>ORIENTIMI</th><th>PERDORIMI</th><th>TIPI KUFIRIT</th><th>KUFITARI</th><th>ID/NIPT</th><th>SHENIME TE REALIZUESIT</th></tr></thead><tbody><tr><td>1</td><td>VERI</td><td></td><td></td><td>2/221</td><td></td><td></td></tr><tr><td>2</td><td>LINDJE</td><td></td><td></td><td>2/264, 2/405</td><td></td><td></td></tr><tr><td>3</td><td>JUG</td><td></td><td></td><td>2/174</td><td></td><td></td></tr><tr><td>4</td><td>PERENDIM</td><td></td><td></td><td>2/146, 2/141</td><td></td><td></td></tr></tbody></table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI			2/221			2	LINDJE			2/264, 2/405			3	JUG			2/174			4	PERENDIM			2/146, 2/141		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI			2/221																																				
2	LINDJE			2/264, 2/405																																				
3	JUG			2/174																																				
4	PERENDIM			2/146, 2/141																																				
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT			TEKNOLOGJIA E MATJEVE:																																					
EMRI:			Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;																																					
LICENCA: NR. DATE			PERCAKTIMI KUFIRIT:																																					
KOMPANIA:			Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;																																					
NIPT:			SHENIME TE VECANTA:																																					
NENSHKRIMI/VULA			PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET																																					
REALIZOI PER ASHK			EMRI																																					
SPECIALISTI			NENSHKRIMI																																					
DVASHK			EMRI																																					
NENSHKRIMI			NENSHKRIMI																																					
KONFIRMOI			EMRI																																					
PERGJEGJESI/DREJTORI			NENSHKRIMI																																					
NENSHKRIMI / VULA			NENSHKRIMI																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								

Tratit (m2)	Kod i mbiemri (m2)	Emri i mbiemri, prezantues i kartës shtetërore cilin	Emri i mbiemri, prezantues i kartës shtetërore cilin	Emri i mbiemri, prezantues i kartës shtetërore cilin	Emri i mbiemri, prezantues i kartës shtetërore cilin	Emri i mbiemri, prezantues i kartës shtetërore cilin	Emri i mbiemri, prezantues i kartës shtetërore cilin	Emri i mbiemri, prezantues i kartës shtetërore cilin	Institucioni me përgjegjësi administrative nësi
----------------	-----------------------	---	---	---	---	---	---	---	--



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE: 10.01.2024		QELIMI: PERDITESIM/REGJISTRIM																																				
VENDNDODHJA																																								
BASHKIA: HIMARE		DVASHK/ZVASHK: VLORE		ZONA KADASTRALE: 1952																																				
TE DHENAT E PASURISE		NUMRI PASURISE: 1/1653		INDEX HARTE: K-34-136-(184-B)																																				
LLOJI PASURISE: ULLISHTE		SIP.PASURISE = 1490 m ²		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT = m ²																																				
		NUMRI KATEVE		NUMRI PEMEVE																																				
KORNIZA REFEREUSE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X 477618 Y 4440958				X 478105 Y 4440958																																				
																																								
SHpjegues KUFIRI TRUALLIT FUNKSIONAL TE NDERTESES SIPERFAQE = 811.78 m² SIP. E GJURMES SE NDERTIMIT = 378.31 m²																																								
SH 1:2500																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"><thead><tr><th>Nr.</th><th>ORIENTIMI</th><th>PERDORIMI</th><th>TIPI KUFIRIT</th><th>KUFITARI</th><th>ID/NIPT</th><th>SHENIME TE REALIZUESIT</th></tr></thead><tbody><tr><td>1</td><td>VERI</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>2</td><td>LINDJE</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>3</td><td>JUG</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>4</td><td>PERENDIM</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></tbody></table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI						2	LINDJE						3	JUG						4	PERENDIM					
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI																																							
2	LINDJE																																							
3	JUG																																							
4	PERENDIM																																							
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: _____ LICENCA: NR. _____ DATE _____ KOMPANIA: _____ NIPT: _____ NENSHKRIMI/VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____																																					
REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ Rembran NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI _____ PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI / VULA _____			PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ NENSHKRIMI _____ Ergysht Digitally signed by Ergysht Skenderi Date: 2024.10.07 13:17:41 +0200																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimit kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



Identifikimi i punës: Joana Kacori (emri, mbiemri, pasqyri zyrtar) Supervizori: Armand Goxhaj (emri, mbiemri, pasqyri zyrtar) Ardhori: Vlora Hyseni DREJTOR (emri, mbiemri, pasqyri zyrtar, tel., faks, vula) Institucioni Qendror Shetëzor, Sherbimi Informativ i Shetit Himare											
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Nga Sipërfaqja (m2)	Funksioni për të cilin përdoret pronat pasurisë	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni përburas i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënimet të veçanta)
1	1952 K-34-136-(184-B)	Pjesë e pas. 1/1135	Truall	Qendër trajnimit dhe kualifikimi Himare	1609.88		Qendër trajnimit dhe kualifikimi	Sherbimi Informativ i Shetit	Sherbimi Informativ i Shetit	VKM 359, datë 5.6.2003	
			Ndërtesë	Godina nr.2 Godina nr.3		271.35 29	Qendër trajnimit dhe kualifikimi Qendër trajnimit dhe kualifikimi	Sherbimi Informativ i Shetit Sherbimi Informativ i Shetit	Sherbimi Informativ i Shetit Sherbimi Informativ i Shetit		2 kate 1 kate



VENDIM

Nr. 782, datë 18.12.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË DETAJUARA PËR AKSESIMIN E
FAQEVE ZYRTARE TË INTERNETIT
TË AUTORITETEVE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çdo autoritet publik është i detyruar të ketë një faqe zyrtare të internetit për të ofruar informacione për autoritetin publik dhe për shërbimet, të cilat i ofron për shtetasit e personat fizikë dhe/ose juridikë, duke zbatuar rregullat e mëposhtme:

a) faqja zyrtare përmban emrin e autoritetit publik, me qëllim identifikimin dhe kontaktimin e tij;

b) adresa e selisë apo qendra kryesore e veprimtarisë së autoritetit publik duhet të jetë e qartë për shtetasit dhe personat fizikë dhe/ose juridikë, që vizitojnë vendndodhjen fizike të tij;

c) faqja zyrtare përmban adresën e postës elektronike shtetërore dhe çdo adresë tjetër për informacion për shtetasit e personat fizikë dhe/ose juridikë për të adresuar çështje dhe për të kërkuar ndihmë në mënyrë efikase;

ç) faqja zyrtare përmban listën e shërbimeve publike elektronike, që ofron autoriteti publik në platformën qeveritare “e-Albania”;

d) faqja zyrtare përmban çdo informacion tjetër të nevojshëm, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për të drejtën e informimit, konsultimit publik, si dhe për sinjalizimin e mbrojtjen e sinjalizuesve;

dh) çdo publikim në faqen zyrtare përmban datën e publikimit dhe datën e përditësimit të fundit;

e) faqja zyrtare përmban emrin dhe adresën e selisë së institucionit/autoritetit që ushtron kontroll për funksionimin e autoritetit publik.

2. Faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike përmbajnë kushtet e përdorimit dhe kufizimet e informacionit të publikuar, ku përfshihen rregullat e mëposhtme:

a) informacion të qartë, transparent dhe të detajuar për mënyrën se si përdoruesit mund të shfrytëzojnë të dhënat e ofruara nga faqja;

b) njoftim publik për përdoruesit për ndryshimet e kryera dhe për çdo modifikim të rëndësishëm në aksesin ose përdorimin e informacionit;

c) ndalimi i përdorimit të informacionit për qëllime tregtare, pa leje të posaçme nga autoriteti publik. Mosrespektimi i këtij kufizimi sjell përgjegjësi ligjore për përdoruesin;

ç) informacioni i publikuar në faqet zyrtare të internetit përdoret i patjetërsuar dhe vetëm për qëllime të ligjshme.

3. Faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) aksesohen nga çdo pajisje që ka akses në internet pavarësisht specifikave të tyre;

b) janë të disponueshme, pa ndërprerje, përgjatë të gjithë ciklit jetësor të tyre në 24 (njëzet e katër) orë në 7 (shtatë) ditë të javës;

c) janë të aksesueshme për përdoruesit pavarësisht vendndodhjes gjeografike të tyre.

4. Faqet zyrtare të internetit pajisen me funksionalitetet e dedikuara për personat me aftësi ndryshe për të lehtësuar qasjen në informacionin për shërbimet që ofrohen nga institucionet publike, si:

a) *zoom* (ndihmon kategorinë e personave me pamje të kufizuara);

b) kontrast (ndihmon kategorinë e personave me disleksë);

c) navigimi me TAB (ndihmon kategorinë e personave paraplegjikë).

5. Faqet zyrtare duhet të zbatojnë protokollin e sigurisë HTTPS dhe versionet e përditësuara të tij për të siguruar komunikimin e sigurt, ndërmjet vizitorit dhe faqes.

6. Informacioni që publikohet në faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike është i lirë të shkarkohet/të transferohet, të ruhet, të përpunohet, të shpërndahet dhe të përdoret, me kusht që të tregohet në mënyrë të qartë burimi i tij dhe të mos paraqitet si informacion origjinal, nëse ka pësuar ndryshime. Në këtë informacion përfshihet:

a) liria për të shkarkuar dhe për të transferuar informacion. Çdo informacion i publikuar në faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike mund të shkarkohet dhe të transferohet lirshëm nga përdoruesit. Përdoruesit kanë të drejtën të ruajnë këto të dhëna në pajisjet e tyre për qëllime informuese ose studimore;



b) përdorimi i informacionit të shkarkuar duhet të kryhet në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e së drejtës së autorit dhe burimin origjinal të informacionit. Ndalohe manipulimi apo ndryshimi i informacionit në mënyrë që ai të prezantohet si i ri ose origjinal, nëse ka pësuar ndryshime nga gjendja e tij fillestare;

c) transparenca dhe identifikimi i burimit, në mënyrë që përdoruesit të jenë në gjendje të verifikojnë saktësinë e informacionit dhe origjinën e tij. Kur informacioni merret dhe rishpërndahet, përdoruesit janë të detyruar të tregojnë burimin origjinal në çdo përpunim, përmbledhje apo përdorim që bëhet publik.

7. Autoritetet publike kanë detyrimin të krijojnë dhe të mirëmbajnë faqet e tyre zyrtare të internetit, lehtësisht të aksesueshme për ofrimin e informacionit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, si dhe informacioni të ofrohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për audiencën e synuar, veçanërisht në rastin e informacionit që është i destinuar për të miturit. Detyrimet përfshijnë:

a) sigurimin që çdo individ, pavarësisht aftësive ose pajisjes që përdor, të mund të ketë akses të plotë në informacionin dhe shërbimet që ofrohen;

b) mirëmbajtjen e faqeve të internetit, duke kryer përditësime të rregullta të përmbajtjes dhe teknologjive të përdorura për të garantuar sigurinë dhe funksionimin e vazhdueshëm, si dhe zbatimin e praktikave më të mira për optimizimin e performancës dhe ngarkimit të faqes;

c) faqet zyrtare të internetit duhet të jenë plotësisht të përshtatura për të funksionuar në një gamë të gjerë pajisjesh dhe platformash, përfshirë kompjutera, desktopë, laptopë, telefona inteligjentë dhe tableta;

ç) informacioni që ofrohet në faqet zyrtare të internetit duhet të jetë i organizuar në mënyrë që të jetë i kuptueshëm dhe i lehtë për t'u naviguar nga audienca e synuar. Përmbajtja duhet të jetë e shkruar me gjuhë të thjeshtë;

d) kur faqet zyrtare ofrojnë informacion ose shërbime për të miturit, ato duhet të përmbajnë udhëzime specifike për prindërit apo kujdestarët, duke përfshirë edhe udhëzime për sigurinë e të dhënave dhe përdorimin e shërbimeve *on-line* nga fëmijët;

dh) autoritetet publike duhet të monitorojnë rregullisht performancën e faqeve të internetit dhe

të mbledhin të dhëna për përvojën e përdoruesve për të identifikuar problemet e aksesueshmërisë dhe për t'i adresuar ato;

e) faqet duhet të kenë ndihmë *on-line*, përfshirë *chatbots*, *FAQ* (pyetje të shpeshta) ose shërbime të mbështetjes për përdoruesit për të siguruar që përdoruesit të marrin ndihmë në kohë reale për të naviguar dhe për të përdorur faqen.

8. Autoritetet publike janë të detyruara të marrin masa për të mbrojtur privatësinë dhe të dhënat personale të përdoruesve, në përputhje me ligjet e aplikueshme për mbrojtjen e të dhënave personale. Çdo përdorim i të dhënave personale nga palë të treta duhet të jetë i pajisur me miratim të qartë nga përdoruesit.

9. Shtetasit dhe personat fizikë dhe/ose juridikë gëzojnë të drejtën për të përdorur pa kufizime të panevojshme dhe pa kërkesa për informacione personale faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike.

10. Faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike përmbajnë informacion të plotë, të saktë dhe të përditësuar periodikisht, për detyrat, kompetencat dhe aktivitetet e autoritetit publik, si dhe për dokumentet e të dhënat e tjera të rëndësishme për publikun.

11. Përpunimi i të dhënave personale, në çdo rast, kryhet në përputhje me parimet, kriteret, si dhe masat tekno-organizative, të zbatueshme për garantimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Mekanizmat e mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë së informacionit duhet të jenë të integruar në faqet zyrtare të internetit për të ndaluar përdorimin e paligjshëm të të dhënave personale dhe për të garantuar mbrojtjen e informacionit të shtetasve.

13. Autoritetet publike garantojnë saktësinë, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e informacioneve që publikojnë.

14. Përveç rasteve, kur me ligj parashikohet ndryshe, faqet zyrtare të institucioneve publike janë faqe të lira dhe pa kufizime në akses.

15. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe autoritetet publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**VENDIM****Nr. 783, datë 18.12.2024****PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT
KOMBËTAR PËR SIGURINË
KIBERNETIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 7, të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (në vijim, Autoriteti) si person juridik, publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit.

2. Autoriteti financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

3. Misioni i Autoritetit është të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë kibernetike për rrjetet dhe sistemet e informacionit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të garantojë siguri e besueshmëri në përdorimin e nënshkrimit elektronik, identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË
AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË
KIBERNETIKE**

1. Autoriteti kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike, nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

2. Autoriteti ka përgjegjësi të organizojë punën për:

a) përcaktimin e masave të sigurisë kibernetike dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit;

b) hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike;

c) koordinimin e veprimtarisë me subjekte të tjera përgjegjëse për sigurinë kibernetike dhe bashkëpunimin në nivel kombëtar e ndërkombëtar

me institucione e organizma në fushën e sigurisë kibernetike;

ç) edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit në fushën e sigurisë kibernetike;

d) zbatimin e standardeve të sigurisë nga ofruesit e shërbimeve të certifikimit;

dh) sigurimin e cilësisë, besueshmërisë dhe përputhshmërisë me standardet ligjore për shërbimet e besuara dhe identifikimit elektronik;

e) kontrollin/monitorimin e zbatimit të standardeve dhe të procedurave të lëshimit të certifikatave të kualifikuara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar.

**III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË
KIBERNETIKE**

1. Autoriteti e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror si drejtori e përgjithshme.

2. Autoriteti drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e institucionit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët.

3. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm dhe të punonjësve të Autoritetit rregullohen në bazë të dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga 2 (dy) zëvendës drejtorë të përgjithshëm. Në detyrën e zëvendës drejtorit të përgjithshëm caktohet një nga drejtorët e drejtorive të përmbajtjes së Autoritetit, i cili, krahas detyrave funksionale, kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga drejtori i përgjithshëm për të mbështetur atë në mbarëvajtjen e institucionit.

5. Drejtori i përgjithshëm ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) siguron zbatimin e legjislacionit në fushën e sigurisë kibernetike, të nënshkrimit elektronik, si dhe të identifikimit elektronik e shërbimeve të besuara;

b) nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda vendit dhe me autoritete homologe të huaja apo organizma të tjerë jashtë vendit;

c) drejton, përpunon programin vjetor për angazhimet e drejtorive dhe përcakton prioritetet në punën e tyre;



ç) raporton në mënyrë periodike dhe sa herë i kërkohet për veprimtarinë e institucionit pranë Kryeministrit;

d) krijon grupe pune për çështje specifike, që kërkon përfshirjen e disa drejtorive të Autoritetit, si dhe monitoron ecurinë e përmbushjes së qëllimit të tyre;

dh) merr vendim për dhënien e masave administrative për kundërvajtjet administrative të kryera nga subjektet e legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike, nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara;

e) miraton programe trajnimi për trajnimin profesional të nëpunësve të Autoritetit;

ë) përgatit analiza, raporte dhe bën propozime për mbarrëvajtjen e punës së strukturave në varësi të tij;

f) siguron miradministrimin e mjeteve financiare e të burimeve materiale të institucionit;

g) kryen çdo funksion tjetër si titullar institucioni, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike, nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

6. Autoriteti, në përmbushje të misionit, të fushave të përgjegjësisë e të përgjegjësiave funksionale të tij, kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) harton e monitoron zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike si institucion përgjegjës, në koordinim me institucionet e tjera përgjegjëse për sigurinë kibernetike;

b) identifikon infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme të informacionit, në bashkëpunim e bashkërendim me subjektet e tjera përgjegjëse për sigurinë kibernetike;

c) vepron si pikë qendrore kontakti në nivel kombëtar e ndërkombëtar, si dhe koordinon e bashkërendon punën me institucionet e sigurisë e të mbrojtjes, si dhe bashkëpunon me subjektet e tjera përgjegjëse për sigurinë kibernetike, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike;

ç) vepron në cilësinë e CSIRT-it Kombëtar dhe CERT-it;

d) bashkëpunon dhe shkëmben informacione të rëndësishme me operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, në lidhje me të dhënat në sisteme, kur ato janë të rrezikuara për shkak të një incidenti kibernetik;

dh) përcakton dhe kontrollon zbatimin e masave të sigurisë kibernetike, që duhet të aplikohen nga

operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit;

e) asiston operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit në menaxhimin e incidenteve kibernetike;

ë) kryen monitorim aktiv të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit nëpërmjet informacioneve të marra nga platformat e jashtme të ngritura nga AKSK-ja ose operatorët e infrastrukturave të informacionit, si dhe nga platformat e brendshme, me kërkesë nga operatorët e infrastrukturave të informacionit, me qëllim evidentimin e parandalimin e veprimeve keqdashëse;

f) bashkëpunon me subjektet përgjegjëse të sigurisë kibernetike në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

g) përgatit skemën kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike, si dhe inkurajon operatorët e infrastrukturave të informacionit për përdorimin e saj;

gj) vendos penalitete për subjektet që nuk zbatojnë detyrimet ligjore, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike, nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik e shërbimet e besuara;

h) krijon dhe administron regjistrin e dokumentimit të incidenteve të sigurisë kibernetike;

i) vlerëson e analizon nivelin e sigurisë së sistemeve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, nëpërmjet kontroleve dhe simulimeve të vazhdueshme, si dhe përcakton masa shtesë për operatorët e infrastrukturave të informacionit për një reagim sa më të shpejtë dhe efikas ndaj incidenteve apo sulmeve kibernetike;

j) regjistron organet e vlerësimit të konformitetit për sigurinë kibernetike për vlerësimin e masave të sigurisë kibernetike;

k) i propozon Kryeministrit shpalljen e gjendjes së krizës kibernetike dhe masat emergjente për zgjidhjen e situatës;

l) raporton në mënyrë periodike në lidhje me incidentet kibernetike pranë ENISA-s dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë, në kuadër të angazhimeve të Republikës së Shqipërisë për çështjet e sigurisë kibernetike;

ll) kryen aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi në fushën e sigurisë kibernetike për të gjitha grupet e shoqërisë;

m) ndërmerr masa të nevojshme, bashkëpunon e bashkërendon punën me institucionet përgjegjëse



për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, për krijimin e një mjedisi *on-line* të sigurt kibernetik në Republikën e Shqipërisë;

n) identifikon, parashikon dhe ndërmerr masat e nevojshme për mbrojtjen ndaj kërcënimeve/sulmeve të mundshme kibernetike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike;

nj) propozon politikat për garantimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, monitorimin, identifikimin dhe reagimin ndaj incidenteve për mbrojtjen ndaj sulmeve/kërcënimeve kibernetike për infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme të informacionit në Republikën e Shqipërisë, si dhe kontribuon në hartimin e politikave për ndërgjegjësimin ndaj rreziqeve kibernetike të qytetarëve, subjekteve private e autoriteteve publike;

o) garanton sigurinë për shërbimet e besuara, në veçanti për garantimin e besueshmërisë dhe të sigurisë në transaksionet elektronike ndërmjet qytetarëve, subjekteve private dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin e shërbimeve publike e private dhe tregtisë elektronike;

p) përcakton rregullat për identifikimin elektronik të sigurt, nënshkrimin elektronik, vulat elektronike, vulat kohore elektronike të kualifikuara, nënshkrimin elektronik të kualifikuar, vulat elektronike të kualifikuara, shërbimet e transmetimit elektronik, shërbimet elektronike të kualifikuara të transmetimit elektronik, autentifikimin e faqeve të internetit, si dhe garantimin e nivelit të lartë të sigurisë për transaksionet elektronike në Republikën e Shqipërisë;

q) përcakton rregullat dhe metodat për verifikimin e vlefshmërisë së produkteve të gjeneruara nga shërbimet e besuara, vendase dhe të huaja, duke mundësuar aksesin publik për kontrollin e vlefshmërisë së tyre nëpërmjet listave të besuara të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe protokollin *on-line* të statusit të certifikatave dhe të listave të revokimit të certifikatave;

r) regjistron e publikon në faqen zyrtare të tij ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara;

rr) ndërpret përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht, veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të certifikimit, kur vërtetohet shkelje e dispozitave ligjore në fuqi për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për të ushtruar veprimtarinë e tij;

s) regjistron dhe jep statusin “i kualifikuar” për ofruesin e shërbimit të besuar, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tij;

sh) mbikëqyr e kontrollon palët e treta, në rastin kur transferohen një ose më shumë nga detyrat e shërbimeve të besuara;

t) realizon kontrollin/monitorimin e zbatimit të standardeve dhe të procedurave të lëshimit të certifikatave të kualifikuara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar;

th) mbikëqyr procesin e lëshimit të certifikatave të kualifikuara elektronike dhe implementimin e nënshkrimit elektronik në shërbimet e administratës publike;

u) garanton zbatimin e standardeve për identifikimin e sigurt të individëve, të cilëve u lëshohen certifikatat e kualifikuara elektronike;

v) harton rregullore dhe udhëzime në përputhje me standardet ndërkombëtare të fushës, me qëllim garantimin e transaksioneve të sigurta elektronike dhe rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në infrastrukturën e rëndësishme dhe kritike të informacionit në Republikën e Shqipërisë.

7. Autoriteti ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e Autoritetit përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

8. Vula e Autoritetit ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Struktura dhe organika e Autoritetit miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

10. Rregullorja për organizimin e brendshëm të punës dhe sjelljen e punonjësve të Autoritetit miratohet nga Kryeministri.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 141, datë 22.2.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 784, datë 18.12.2024

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE
AEROPORTUALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale, në lidhje me ndikimet që mund të kenë në sigurinë në operim, ndërtimet e propozuara apo përdorimin e tokës në zonat e mbrojtura të aeroportit dhe jashtë tyre.

2. Zona e mbrojtur e aeroportit, në kuptim të këtij vendimi, nënkupton zonën territoriale, e cila shtrihet në një rreze prej 15 (pesëmbëdhjetë) km nga pika e referimit të aeroportit.

3. Pika e referimit të aeroportit është vendndodhja gjeografike, e përcaktuar me koordinata në bazë të sistemit WGS84 për një aeroport, sipas informacionit të publikimit aeronautik shqiptar (AIP).

4. Përfshihen nga zbatimi i këtij vendimi aeroportet që përdoren ekskluzivisht për qëllime ushtarake.

5. Autoritetet përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e rregullave në zonën e mbrojtur të aeroportit janë ministria përgjegjëse për transportin ajror, Autoriteti i Aviacionit Civil (në vijim “AAC”) dhe autoritetet kompetente për kontrollin e territorit.

6. Leja për zhvillim apo ndërtim në zonat e mbrojtura të aeroportit merret pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (në vijim “KKTU”), sipas parashikimeve në vendimin nr. 408, datë

13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

7. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit marrin mendimin e Autoritetit të Aviacionit Civil për çdo praktikë aplikimi për leje zhvillimi, leje ndërtimi apo praktikë hartimi dokumentesh për planifikim të territorit, që përmban objekte, struktura apo instalime që ndodhen në zonat e mbrojtura të aeroportit.

8. Çdo objekt apo strukturë e planifikuar për ndërtim apo instalim në zonat e mbrojtura të aeroportit duhet që të marrë, sipas rastit, miratimin ose pëlqimin nga AAC-ja.

9. Objektet, strukturat apo instalimet do t'i njoftohen AAC-së, në lidhje me lartësinë, koordinatat dhe strukturën apo llojin e ndërtimit. Koordinatat e përdorura duhet të jenë në formatin WGS84.

10. Zhvillimi, ndërtimi ose përdorimi i pasurive të paluajtshme, brenda zonës së mbrojtur të aeroportit, për aktivitete apo veprimtari, të cilat mund të tërheqin botën shtazore, do t'i njoftohen për vlerësim AAC-së. AAC-ja jep vlerësimin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga bërja e kërkesës.

11. AAC-ja përcakton nëse objektet apo strukturat e planifikuara për ndërtim apo instalim në zonat e mbrojtura janë objekte të rrezikshme, për shkak të vendndodhjes, lartësisë ose mungesës së shënimit apo ndriçimit të tyre. Për këtë qëllim, subjektet zhvilluese, të cilat marrin vlerësimin pozitiv nga AAC-ja, duhet të njoftojnë këtë të fundit për fillimin e punimeve dhe përfundimin e tyre.

12. AAC-ja shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e bërjes së kërkesës, sipas pikave 7 dhe 8, të këtij vendimi. Nëse AAC-ja nuk shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve, kërkesa quhet e pranuar dhe pa vërejtje.

13. Në çdo rast, subjektet që kërkojnë të bëjnë zhvillime ose ndryshime në pasuritë apo objektet që kanë në pronësi, duhet të ndjekin procedurën e parashikuar në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, pranë KKTU-së.

14. Për shkeljen e dispozitave që lidhen me kryerjen e zhvillimeve apo ndërtimeve në zonat e mbrojtura të aeroportit merren masa administrative, sipas parashikimeve në ligjin nr. 107/2014, “Për



planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

15. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 785, datë 18.12.2024

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË
TERMOCENTRALIT DHE VEPRAVE
NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË
OBJEKT KONCESIONI, ME
VENDNDODHJE NË ROSKOVEC,
QARKU FIER, NGA SHOQËRIA
“FIER THERMOELECTRIC”, SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të termocentralit dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në Roskovec, qarku Fier, nga shoqëria “Fier Thermoelectric” sh.a., me elementet, si më poshtë vijon:

a) emri i aplikuesit: shoqëria “Fier Thermoelectric” sh.a.;

b) numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: M22211019U;

c) tipi i centralit: termocentral;

ç) kapaciteti i instaluar: 170 mw;

d) afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaiik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

Faqe | 24872

dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në Roskovec, qarku Fier;

e) afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme, me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionin e projektit;

g) shoqëria “Fier Thermoelectric” sh.a., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të termocentralit;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “Fier Thermoelectric” sh.a., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “Fier Thermoelectric” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



ANEKSI 1

Koordinatat KRGJSH		
PIKAT	X (E)	Y (N)
1	473859.173	4514528.518
2	474040.579	4514756.205
3	474236.79	4514570.101
4	474236.957	4514557.495



Koordinatat e zones sipas 3 projeksioneve hartografike							
	Gauss-Kruger		KRGJSH		UTM		
	E/X	N/Y	E/X	N/Y	E/X	N/Y	
A	4389555.129	4515438.371	473859.173	4514528.518	389468.753	4513501.504	
B	4389739.146	4515664.009	474040.579	4514756.205	389652.695	4513727.05	
C	4389933.252	4515475.652	474236.79	4514570.101	389846.722	4513538.77	
D	4389933.275	4515463.043	474236.957	4514557.495	389846.745	4513526.167	

**VENDIM****Nr. 786, datë 18.12.2024****PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË KOMANDËN E NATO-s
NË WIESBADEN, GJERMANI, PËR
NDIHMË DHE TRAJNIM
PËR UKRAINËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen në Komandën e NATO-s në *Wiesbaden*, Gjermani, të 4 (katër) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për ndihmë dhe trajnim për Ukrainën.

2. Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është të kontribuojë në dhënien e ndihmës dhe trajnimit të personelit të Forcave të Armatosura të Ukrainës.

3. Pjesëmarrja e personelit do të ketë një kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh, me rotacion 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë. Afati i misionit fillon të llogaritet nga data e dërgimit në mision. Periudhës së qëndrimit në mision i shtohen edhe ditët e qëndrimit për marrje e dorëzim detyrë dhe të vonesave të transportit strategjik për ndërrimin me personelin e radhës.

4. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë mision, përballon shpenzimet për:

- a) dietat për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
- b) akomodim;
- c) ushqim;
- ç) lavanderi;

- d) ujë të pijshëm;
- dh) energji elektrike;
- e) sigurimin e jetës;
- ë) siguracion shëndetësor për ditët në udhëtim;
- f) mbështetje shëndetësore;
- g) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;
- gj) transport;
- h) transportin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;
- i) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare gjatë kryerjes së misionit;
- j) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

5. Transportimi për në atdhe i individëve të shkëputur nga misioni, në rast vdekjeje, sëmundjeje, pamundësie për të përfunduar misionin ose thyerjeje disipline, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe, ku pala/palët tjetër/e tjera merr/marrin përsipër përballimin e këtyre shpenzimeve.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM**Nr. 788, datë 18.12.2024****PËR DEKLARIMIN “PASURI
KULTURORE E PALUAJTSHME” TË
ZONAVE ARKEOLOGJIKE A DHE B TË
QYTETIT TË SHKODRËS, MIRATIMIN
E ZONIFIKIMIT DHE TË PLANIT PËR
RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 9, e të nënndarjes “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e



ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin “Pasuri kulturore e paluajtshme” të zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Shkodrës.

2. Miratimin e zonifikimit të zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Shkodrës, sipas koordinatave dhe hartave të zonifikimit në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Vendimi nr. 429, datë 9.6.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Shkodrës dhe miratimin e rregullores së administrimit”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe aktet nënligjore në fuqi.

6. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartat e zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Shkodrës në Gjeoportalin Kombëtar.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLANI **PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE** **ADMINISTRIMIN E ZONAVE** **ARKEOLOGJIKE A DHE B TË QYTETIT** **TË SHKODRËS**

Neni 1
Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Shkodrës, si dhe përcaktimin e

kufijve të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

Neni 2

Hapësira urbane arkeologjike në mbrojtje

1. Hapësira urbane me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e qytetit të Shkodrës, pjesë e trashëgimisë kulturore, përbëhet nga:

- a) zona arkeologjike A;
- b) zona arkeologjike B.

2. Kufijtë e zonave arkeologjike A dhe B paraqiten në hartat e zonifikimit të qytetit të Shkodrës me koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar – KRGJSH, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Hartimi dhe miratimi i instrumenteve të planifikimit urban të qytetit të Shkodrës merr në konsideratë kufijtë e zonifikimit të zonave arkeologjike A dhe B, të qytetit të Shkodrës”, si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

Neni 3

Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike **A të qytetit të Shkodrës**

1. Në zonën arkeologjike A të qytetit të Shkodrës lejohet vetëm:

a) mirëmbajtja, restaurimi dhe konservimi i integruar i monumenteve të kulturës dhe i strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KKTKM”);

b) kryerja e formave të testimit, të tilla si: sondazhe që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, hulumtime arkeologjike parandaluese dhe të shpëtimit, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore të miratuara nga struktura përgjegjëse për miratimin e projekteve kërkimore-shkencore pranë Akademisë së Shkencave, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja;

ç) rikonstruksioni i rrugëve dhe i të gjitha punimeve në rrejetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

d) rikonstruksioni/rindërtimi i godinave ekzistuese pa ndryshim të gjurmës, volumi i përgjithshëm i të cilave nuk cenon pasuritë kulturore



të nëntokës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

dh) vendosja e konstruksioneve të lehta të përkohshme (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 1 kat, në funksion të informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, trashëgiminë kulturore, si dhe të nevojave të tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë vijon:

i. konstruksionet duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin;

ii. projekti për vendosjen e konstruksioneve të lehta miratohet nga KKTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen e strukturës;

iii. vendosja e tyre duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore të specializuara.

2. Projekti për strukturat e përmendura në shkronjën “dh”, të këtij neni, miratohet nga KKTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe plan-projektin e saj. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike A të qytetit të Shkodrës, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja e më pas vijojnë procedurën, sipas ligjit të planifikimit e të zhvillimit të territorit.

Neni 4

Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike B të qytetit të Shkodrës

1. Në zonën arkeologjike B të qytetit të Shkodrës, përveç ndërhyrjeve që lejohen në zonën arkeologjike A, lejohen edhe ndërtimet e reja pas miratimit nga KKTKM-ja.

2. Projektet për ndërtimet e reja shqyrtohen e miratohen nga KKTKM-ja dhe vijojnë procedurën, sipas ligjit të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit.

3. Ndërtimet e reja lejohen vetëm pas kryerjes të formave të testimit, të përcaktuara nga KKTKM-ja, në varësi të potencialit arkeologjik që përfaqëson zona.

4. Gërmimi arkeologjik kryhet sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Neni 5

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike A dhe B të qytetit të Shkodrës, projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 80, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, pas aplikimit nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.

2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton dhe vendos për kryerjen ose jo të formave të testimit. Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim “ITK”).

4. Për ndërhyrjet e parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, përpara zbatimit të tyre, me miratim të KKTKM-së, nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike ose institucionet e specializuara shtetërore realizohen:

a) format e testimit sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, të mbikëqyrura nga institucionet shtetërore të specializuara;

b) monitorimi arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara.

4. Për të gjitha ndërhyrjet në zonat arkeologjike realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike dhe/ose institucione shtetërore të specializuara dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

6. Ndërtimet pa leje, të ndodhura brenda kufirit të zonave arkeologjike A dhe B, trajtohen në përputhje me ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Shprehja e autoriteteve të trashëgimisë kulturore është kusht për përfundimin e procedurave të legalizimit për të gjitha rastet e specifikuara shprehimisht në ligj.



Neni 6

Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paaautorizuara në zonat arkeologjike A dhe B, të qytetit të Shkodrës

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paaautorizuara brenda zonave arkeologjike A dhe B, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Shkodrës, ka detyrimin të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit, nëpërmjet aktit të konstatimit.

2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Shkodrës, njofton menjëherë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Në rast se subjekti nuk ndërpret veprimet menjëherë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Shkodrës, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, për marrjen e masave përkatëse në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Neni 7

Gjetjet rastësore arkeologjike

1. Klasifikohen si gjetje rastësore arkeologjike objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet e tyre arkeologjike dhe strukturat arkitektonike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

2. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të punimeve në zonat arkeologjike, punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së

përcaktuar në nenin 145, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

3. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për procedurën dhe hulumtimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e tyre.

4. Për çdo rast, veprimtaria arkeologjike realizohet sipas parashikimeve të neneve 139, 145, 146, 147, 260, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Neni 8

Vendosja e tabelave prezantuese dhe e paneleve shpjeguese

1. Në zonat arkeologjike A dhe B lejohet vendosja e tabelave prezantuese dhe e paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, pas shqyrtimit e miratimit nga KKTKM-ja.

2. Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të konkurrojnë pamjen, peizazhin dhe integritetin e monumenteve, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike.


3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre, dëshmimeve dhe gjetjeve arkeologjike bëhet nën mbikëqyrjen e DRTK-së, përgjegjëse për qytetin e Shkodrës, pas njoftimit zyrtar nga Bashkia Shkodër.

4. Është e ndaluar vendosja e posterave apo e mjeteve të tjera reklamuese, si dhe dëmtimet e tjera (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme) të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike.

Neni 9

Trajtimi i rasteve të paparashikuara

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.



Zona Arkeologjike A Shkodër
Koordinatat në sistemin KRGJSH

E		N
1	457912.0064	4656501.906
2	458.3953	4656490.45
3	457899.8764	4656476.588
4	457870.8459	4656442.372
5	457836.1317	4656405.337
6	457774.6007	4656362.06
7	457681.7876	4656291.527
8	457645.3942	4656329.074
9	457612.2388	4656391.875
10	457591.5643	4656462.431
11	457597.1337	4656523.699
12	457608.5199	4656568.494
13	457629.5374	4656610.093
14	457636.1048	4656642.591
15	457654.5379	4656678.867
16	457688.3825	4656726.902
17	457774.2472	4656796.387
18	457806.2117	4656892.039
19	457850.359	4656964.345
20	457885.3003	4657003.461
21	457913.9954	4657039.195
22	457933.8792	4657064.57
23	457956.7249	4657147.876
24	458080.5643	4657336.573
25	458149.1683	4657439.27
26	458242.2696	4657540.6
27	458254.9748	4657529.169



28	458251.1579	4657431.199
29	458208.2332	4657367.509
30	458210.8987	4657309.314
31	458204.0546	4657272.182
32	458252.6332	4657220.148
33	458288.7851	4657155.728
34	458301.8403	4657142.648
35	458354.7289	4657118.123
36	458388.7124	4657097.678
37	458406.6733	4657061.166
38	458415.8906	4657036.792
39	458393.403	4657007.747
40	458365.7157	4656970.702
41	458358.1443	4656939.184
42	458363.5142	4656932.631
43	458357.2912	4656927.265
44	458337.1634	4656866.157
45	458334.6602	4656853.887
46	458300.1618	4656805.183
47	458287.9924	4656799.085
48	458206.2673	4656715.092
49	458129.3551	4656672.177
50	458010.5842	4656615.871
51	457985.1448	4656612.927
52	457872.2356	4656621.201
53	457855.4159	4656616.704
54	457851.9204	4656604.422
55	457873.5816	4656562.66
56	457895.5427	4656523.548

Zona Arkeologjike B Shkodër
Koordinatat në sistemin KRGJSH

	E	N
1	457932.5759	4656487.121
2	457915.6736	4656477.997
3	457894.7531	4656460.92
4	457839.2425	4656400.722
5	457784.2473	4656364.35
6	457683.5887	4656290.274
7	457588.7565	4656217.38
8	457552.0786	4656207.953
9	457370.3787	4656106.845
10	457289.7836	4656073.349
11	457256.0956	4656079.837
12	457245.2692	4656100.354
13	457242.1466	4656141.075
14	457276.6663	4656267.193
15	457375.2365	4656415.763
16	457510.6692	4656671.158
17	457630.2453	4656788.742
18	457835.4529	4657097.621
19	457937.5437	4657284.608
20	457953.4293	4657352.018
21	457966.6034	4657379.697
22	458009.9901	4657471.778
23	458053.9632	4657536.341
24	458427.7469	4657755.882
25	458437.0707	4657750.698



26	458445.3701	4657742.591
27	458444.1336	4657735.166
28	458419.7832	4657712.649
29	458718.82	4657353.292
30	458770.4807	4657258.353
31	458778.3588	4657150.463
32	458838.2787	4657050.856
33	459008.9978	4656800.892
34	458655.7108	4656707.041
35	458516.7721	4656660.953
36	458329.9827	4656655.593
37	458272.3157	4656653.067
38	458206.3477	4656636.151
39	458087.1029	4656580.766
40	458028.3974	4656553.878

VENDIM**Nr. 789, datë 18.12.2024****PËR DEKLARIMIN “PASURI
KULTURORE E PALUAJTSHME” TË
ZONAVE ARKEOLOGJIKE A DHE B TË
QYTETIT TË VLORËS, MIRATIMIN E
ZONIFIKIMIT DHE TË PLANIT PËR
RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 9, e të nënndarjes “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin “Pasuri kulturore e paluajtshme” të zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Vlorës.
2. Miratimin e zonifikimit të zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Vlorës, sipas koordinatave dhe hartave të zonifikimit në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Vendimi nr. 729, datë 1.9.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Vlorës dhe miratimin e rregullores së administrimit”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe me aktet nënligjore në fuqi.

6. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësor të publikojë hartat e zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Vlorës në Gjeoportalin Kombëtar.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku****PLANI****PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E ZONAVE
ARKEOLOGJIKE A DHE B TË QYTETIT
TË VLORËS****Neni 1****Qëllimi**

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore, përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Vlorës, si dhe përcaktimin e kufijve të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.



Neni 2

Hapësira urbane arkeologjike në mbrojtje

1. Hapësira urbane me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e qytetit të Vlorës, pjesë e trashëgimisë kulturore, përbëhet nga:

- a) zona arkeologjike A;
- b) zona arkeologjike B.

2. Kufijtë e zonave arkeologjike A dhe B paraqiten në hartat e zonifikimit të qytetit të Vlorës, me koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar-KRGJSH, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Hartimi dhe miratimi i instrumenteve të planifikimit urban të qytetit të Vlorës marrin në konsideratë kufijtë e zonifikimit të zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Vlorës, si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

Neni 3

Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike A të qytetit të Vlorës

1. Në zonën arkeologjike A të qytetit të Vlorës lejohet vetëm:

a) mirëmbajtja, restaurimi dhe konservimi i integruar i monumenteve të kulturës dhe strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KKTKM”);

b) kryerja e formave të testimit, të tilla si sondazhe që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, hulumtime arkeologjike parandaluese dhe të shpëtimit, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore, të miratuara nga struktura përgjegjëse për miratimin e projekteve kërkimore-shkencore pranë Akademisë së Shkencave, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja;

ç) rikonstruksioni i rrugëve dhe i të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik, mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

d) rikonstruksioni/rindërtimi i godinave ekzistuese, pa ndryshim të gjurmës, volumi i përgjithshëm i të cilave nuk cenon pasuritë kulturore të nëntokës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

dh) vendosja e konstruksioneve të lehta të përkohshme (dru, xham, plastikë, metal), me lartësi

maksimale 1 kat, në funksion të informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, trashëgiminë kulturore, si dhe nevojave të tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë vijon:

i. Konstruksionet duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin;

ii. Projekti për vendosjen e konstruksioneve të lehta miratohet nga KKTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen e strukturës;

iii. Vendosja e tyre duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore të specializuara.

2. Projekti për strukturat e përmendura në shkronjën “dh”, të këtij neni, miratohet nga KKTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe plan-projektin e saj. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike A të qytetit të Vlorës, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d” e “dh”, të pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe më pas vijojnë procedurën, sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Neni 4

Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike B të qytetit të Vlorës

1. Në zonën arkeologjike B të qytetit të Vlorës, përveç ndërhyrjeve që lejohen në zonën arkeologjike A, lejohen edhe ndërtimet e reja, pas miratimit nga KKTKM-ja.

2. Projektet për ndërtimet e reja shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe vijojnë procedurën, sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Ndërtimet e reja lejohen vetëm pas kryerjes të formave të testimit, të përcaktuara nga KKTKM-ja, në varësi të potencialit arkeologjik, që përfaqëson zona.

4. Gërmimi arkeologjik kryhet sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.



Neni 5

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike A dhe B të qytetit të Vlorës, projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 80, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, pas aplikimit nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”.

2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton dhe vendos për kryerjen ose jo të formave të testimit. Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim “IKTK”).

4. Për ndërhyrjet e parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, përpara zbatimit të tyre, me miratim të KKTKM-së, nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike ose institucionet e specializuara shtetërore realizohen:

a) format e testimit, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij plani, të mbikëqyrura nga institucionet shtetërore të specializuara;

b) monitorimi arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara.

5. Për të gjitha ndërhyrjet në zonat arkeologjike realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike dhe/ose institucione shtetërore të specializuara dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

6. Ndërtimet pa leje, të ndodhura brenda kufirit të zonave arkeologjike A dhe B, trajtohen në përputhje me ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij. Shprehja e autoriteteve të trashëgimisë kulturore është kusht për përfundimin e procedurave të legalizimit për të gjitha rastet e specifikuara shprehimisht në ligj.

Neni 6

Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paaautorizuara në zonat arkeologjike A dhe B, të qytetit të Vlorës

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paaautorizuara, brenda zonave arkeologjike A dhe B, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Vlorës, ka detyrimin të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit, nëpërmjet aktit të konstatimit.

2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Vlorës, njofton menjëherë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Në rast se subjekti nuk ndërpret veprimet menjëherë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Vlorës, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore për marrjen e masave përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Neni 7

Gjetjet rastësore arkeologjike

1. Klasifikohen si gjetje rastësore arkeologjike objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet e tyre arkeologjike dhe strukturat arkitektonike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

2. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike, gjatë zbatimit të punimeve në zonat arkeologjike, punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 145, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

3. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për procedurën dhe hulumtimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e tyre.

4. Për çdo rast, veprimtaria arkeologjike realizohet sipas parashikimeve të neneve 139, 145,

146, 147, 260, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Neni 8

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonat arkeologjike A dhe B lejohet vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, pas shqyrtimit e miratimit nga KKTKM-ja.

2. Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të konkurrojnë pamjen, peizazhin dhe integritetin e monumentet, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të


mbrojtura rreth tyre, dëshmime dhe gjetjeve arkeologjike bëhet nën mbikëqyrjen e DRTK-së, përgjegjëse për qytetin e Vlorës, pas njoftimit zyrtar nga Bashkia Vlorë.

4. Është e ndaluar vendosja e posterave apo e mjeteve të tjera reklamuese, si dhe dëmtimet e tjera (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme) të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike.

Neni 9

Trajtimi i rasteve të paparashikuara

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.





Zona Arkeologjike A – Vlorë
Koordinata në sistemin KRGJSH

	E	N
1	456806.39	4482128.76
2	456858.47	4481896.78
3	456861.55	4481832.24
4	456852.17	4481774.42
5	456843.21	4481693.08
6	456813.39	4481691.26
7	456763.41	4481787.72
8	456727.85	4481799.06
9	456647.77	4481838.4
10	456619.91	4481838.82
11	456604.55	4482056.42
12	456695.83	4482097.44
13	456755.89	4482117.32

Zona arkeologjike A – Vlorë – Kalaja e Skelës
Koordinata në sistemin KRGJSH

	E	N
1	456546.33	4480452.42
2	456847.97	4480370.81
3	456834.67	4480323.77
4	456854.41	4480296.33
5	456844.19	4480215.55
6	456833.55	4480215.55
7	456824.17	4480172.85
8	456.43	4480156.61
9	456786.93	4480123.29
10	456768.31	4480059.03
11	456490.83	4480121.05
12	456467.59	4480161.23

Zona arkeologjike B Vlorë

Nr.	E	N
1	456536.03	4482267.35
2	456591.75	4482271.27
3	456781.71	4482203.93
4	456761.55	4482281.07
5	456807.05	4482291.43
6	456807.47	4482296.19
7	456834.49	4482313.41
8	456844.29	4482303.05
9	456847.28	4482286.02
10	456927.36	4482300.02
11	456931.14	4482306.46



12	456949.76	4482304.78
13	456960.96	4482271.74
14	456976.5	4482238.56
15	456960.26	4482223.16
16	456975.52	4482203.28
17	456969.78	4482199.36
18	456982.8	4482148.05
19	456994	4482126.77
20	457015.56	4482060.83
21	457018.64	4482013.93
22	457010.66	4481991.25
23	457050.7	4481970.53
24	457034.67	4481876.29
25	457058.19	4481827.01
26	457032.57	4481812.03
27	457024.31	4481764.99
28	457036.35	4481735.87
29	457010.45	4481722.99
30	457005.55	4481702.69
31	456978.25	4481704.79
32	456946.61	4481667.27
33	456853.09	4481676.23
34	456800.31	4481664.75
35	456743.05	4481678.75
36	456670.81	4481674.13
37	456654.15	4481652.99
38	456639.45	4481650.47
39	456635.87	4481643.48
40	456622.79	4481644.45
41	456621.39	4481650.05
42	456605.29	4481648.51
43	456598.01	4481661.39
44	456539.63	4481644.87
45	456472.01	4481614.77
46	456420.33	4481719.62
47	456385.05	4481716.68
48	456387.45	4481814.41
49	456480.83	4481822.26
50	456470.18	4481930.47
51	456474.24	4481930.75
52	456465.49	4482128.02
53	456543.19	4482131.8



VENDIM

Nr. 790, datë 18.12.2024

**PËR DEKLARIMIN “PASURI
KULTURORE” TË ZONËS
ARKEOLOGJIKE NËNUJORE A TË
VENDBANIMIT PALAFIT TË FSHATIT
LIN NË POGRADEC, MIRATIMIN E
ZONIFIKIMIT DHE TË PLANIT PËR
RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E KËSAJ ZONE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të nënndarjes “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, e të nenit 153, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin “Pasuri kulturore” të zonës arkeologjike nënujore të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec.

2. Miratimin e zonifikimit të zonës arkeologjike nënujore A të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec, sipas hartës dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e kësaj zone, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe me aktet nënligjore në fuqi.

5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e zonës arkeologjike nënujore A të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec në Gjeoportalin Kombëtar.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

**PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN
DHE ADMINISTRIMIN E ZONËS
ARKEOLOGJIKE NËNUJORE A TË
VENDBANIMIT PALAFIT TË FSHATIT
LIN NË POGRADEC**

Neni 1

Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore, përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike nënujore A të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec, si dhe përcaktimin e kufijve të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

Neni 2

Hapësira arkeologjike nënujore në mbrojtje

1. Hapësira nënujore me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec, pjesë e trashëgimisë kulturore, dhe e pasurisë botërore ndërkufitare “Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit”, shpallur me vendim të Komitetit të Trashëgimisë Botërore 43 COM 8B.9, viti 2019”, përbëhet nga:

- zona arkeologjike nënujore A.

2. Kufijtë e zonës arkeologjike nënujore A paraqiten në hartën e zonifikimit të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec, shoqëruar me koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar-KRGJSH, pjesë përbërëse e këtij plani.

3. Hartimi dhe miratimi i instrumenteve të planifikimit në lidhje me hapësirën arkeologjike në mbrojtje të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec kryhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

4. Në zonën e mbrojtur natyrore zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura.

Neni 3

**Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike
nënujore A**

1. Në zonën arkeologjike nënujore A të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec lejohet vetëm:



a) mirëmbajtja, hulumtimi dhe muzealizimi i strukturave arkeologjike/anijeve të mbytura, rrënojat dhe çdo objekt që gjendet në shtresat nënujore dhe paraqet interes etnografik, arkeologjik, historik, si dhe çdo potencial arkeologjik nënujë, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KKTKM”);

b) kryerja e formave të testimit, të tilla si vrojtim arkeologjik nënujor, sondazhe arkeologjike nënujore, që nuk cenojnë/dëmtojnë pasurinë arkeologjike nënujore, regjistrim digjital i gjetjeve nga institucione të specializuara ose subjekte të licencuara, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) zbatimi i projekteve kërkimore shkencore, të miratuara nga struktura përgjegjëse për miratimin e projekteve kërkimore-shkencore pranë Akademisë së Shkencave, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja.

2. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike nënujore A, të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec, të parashikuara në pikën “c”, të këtij neni, shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe më pas vijojnë procedurën, sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Çdo projekt ose aktivitet i zhvilluar në hapësirën e mbrojtur nënujore A, pas miratimit nga KKTKM-ja, mbikëqyret nga institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

4. Aktivitetet me karakter turistik, që zhvillohen dhe organizohen nga subjekte të licencuara nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike nënujore A

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike nënujore A, projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 155, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton dhe vendos për kryerjen ose jo të formave të testimit.

Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara në fushën e arkeologjisë. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është IKTK-ja.

4. Për të gjitha ndërhyrjet në zonat arkeologjike nënujore realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara, si dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

Neni 5

Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paautorizuara në zonën arkeologjike nënujore A të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paautorizuara, brenda zonës arkeologjike nënujore A, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) për zonën e Pogradecit ka detyrimin të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit, nëpërmjet aktit të konstatimit.

2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) njofton menjëherë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Në rast se subjekti nuk ndërpret veprimet brenda 24 orëve, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për zonën e Pogradecit, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, për marrjen e masave përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Neni 6

Aktivitetet e ndaluara në zonën arkeologjike nënujore A të vendbanimit palafit të fshatit Lin në Pogradec

1. Ndalohen të gjitha aktivitetet e tjera nënujore, që nuk janë parashikuar në këtë plan, si:

a) aktivitetet e peshkimit në të gjitha format e tij;



b) aktivitete dhe zhytje nënujore, të paaautorizuara apo të pamiratuara më parë nga institucionet përkatëse.

Neni 7

Gjetjet rastësore arkeologjike nënujore/detare

1. Klasifikohen si gjetje rastësore arkeologjike nënujore/detare, objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet e tyre arkeologjike dhe strukturat arkitektonike.

2. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike, gjatë zbatimit të punimeve në zonat arkeologjike, punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 160, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

3. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për

procedurën dhe hulumtimet arkeologjike, të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e tyre.

4. Për çdo rast, veprimtaria arkeologjike nënujore realizohet sipas parashikimeve të neneve 151, 152, 153, 154, 155, 156, 158, 159, 160, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Neni 8

Trajtimi i rasteve të paparashikuara

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.



**Zona arkeologjike nenujore - Lin,
Pogradec**

Koordinata ne KRGJSH

	E	N
1	553242.47	4546114.14
2	553326.33	4546076.9
3	553381.07	4546130.8
4	553398.57	4546121.7
5	553422.23	4546104.48
6	553498.11	4546001.3
7	553449.3	4545747.03
8	553236.5	4545779.65
9	553223.62	4545824.31
10	553208.22	4545893.75
11	553202.06	4545956.05
12	553221.66	4546037.67



URDHËR

Nr. 307, datë 10.12.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR REGJISTRIMIN E PERSONAVE
QË LUNDROJNË NË BORDIN E
ANIJEVE TË PASAGJERËVE QË
OPEROJNË DREJT OSE NGA PORTET
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, shkronjës “b”, të nenit 401, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre anëtare”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për regjistrimin e personave që lundrojnë në bordin e anijeve të pasagjerëve që operojnë drejt ose nga portet e Republikës së Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Administrata Detare Shqiptare për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE

**PËR REGJISTRIMIN E PERSONAVE QË
LUNDROJNË NË BORDIN E ANIJEVE TË
PASAGJERËVE QË OPEROJNË DREJT
OSE NGA PORTET E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rritja e sigurisë dhe mundësisë së shpëtimit të pasagjerëve dhe

ekuipazhit në bordin e anijeve të pasagjerëve që operojnë në ose nga portet e Republikës së Shqipërisë dhe për të siguruar që kërkim/shpëtimi dhe pasojat e ndonjë aksidenti që mund të ndodhë mund të trajtohen në mënyrë më efektive.

Neni 2

Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “*Persona*” do të thotë të gjithë njerëzit në bord, pavarësisht nga mosha;

2. “*Konventa Ndërkombëtare*” nënkupton Konventën Ndërkombëtare të vitit 1974 për Sigurinë e Jetës në Det (Konventa SOLAS e 1974), e ndryshuar, e ratifikuar me ligjin nr. 9032/2003, së bashku me protokollat dhe amendamentet e tyre;

3. “*Anije pasagjerësh*” do të thotë një anije ose një mjet detar, i cili transporton më shumë se 12 pasagjerë;

4. “*Anije me shpejtësi të lartë*” do të thotë një mjet detar me shpejtësi të lartë siç përcaktohet në rregulloren 1, të kapitullit X, të Konventës SOLAS të vitit 1974, në versionin e përditësuar;

5. “*Shoqëri*” do të thotë pronari i një anijeje pasagjerësh ose i ndonjë organizate, ose person siç është menaxheri ose qiradhënësi i anijeve, i cili ka marrë përgjegjësinë nga pronari për operimin e anijes së pasagjerëve;

6. “*Kodi ISM*” do të thotë Kodi Ndërkombëtar i Menaxhimit për Funksionimin e Sigurt të anijeve dhe Parandalimit të Ndotjes miratuar nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO) përmes rezolutës së Asamblesë A.741(18), të datës 4 nëntor 1993, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 16.11.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code)’”;

7. “*Regjistri i pasagjerëve*” do të thotë personi përgjegjës i caktuar nga një shoqëri për të përmbushur detyrimet e Kodit ISM, kur është e zbatueshme, ose një person i caktuar nga një shoqëri si përgjegjës për transmetimin e

që operojnë drejt ose nga portet e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

¹ Kjo rregullore përaftron plotësisht direktivën e Këshillit 98/41/KE, e 18 qershorit 1998, “Për regjistrimin e personave që lundrojnë në bordin e anijeve të pasagjerëve



informacionit për personat që kanë hipur në një anije pasagjerësh të shoqërisë;

8. “Autoriteti i caktuar” do të thotë autoritetet ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, përgjegjëse për kërkim/shpëtimin, dhe institucionet që do të kenë akses në informacionin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje;

9. “Një milje” është 1852 metra;

10. “Shërbim i rregullt” do të thotë një seri kalimesh të anijeve që operojnë, në mënyrë që t’i shërbejnë trafikut ndërmjet dy ose më shumë porteve të njëjta, ose një sërë udhëtimesh nga dhe në të njëjtin port pa thirrje të ndërmjetme:

a) sipas një orari të publikuar; ose

b) me kalime aq të rregullta ose të shpeshta saqë përbëjnë një seri sistematike të dallueshme;

11. “Shtet joanëtar” do të thotë çdo vend që nuk është shtet anëtar i Bashkimit Evropian;

12. “Zonë portuale” nënkupton një zonë të ndryshme nga një zonë detare, e përcaktuar nga administrata detare me juridiksion mbi të, që shtrihet në punimet e përhershme portuale më të jashtme që përbëjnë një pjesë integrale të sistemit të portit, ose në kufijtë e përcaktuar nga karakteristikat natyrore gjeografike që mbrojnë një grykëderdhje ose një zonë të ngjashme të mbrojtur;

13. “Jaht argëtimi ose mjet lundrimi argëtimi” do të thotë një anije që nuk përdoret për qëllime tregtare, pavarësisht nga fuqia motorike.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore do të zbatohet për anijet e pasagjerëve, me përjashtim të:

a) anijeve të luftës dhe anijet e trupave;

b) jahte argëtimi dhe mjetet e argëtimit;

c) anijet e angazhuara ekskluzivisht në zonat portuale ose në rrugët ujore të brendshme.

Neni 4

Numërimi dhe raportimi i personave në Bordin e Anijeve Pasagjere

1. Të gjithë personat në bordin e çdo anije pasagjerësh që nisen nga portet shqiptare do të numërohen para se anija të largohet nga porti.

2. Para nisjes së anijes së pasagjerëve, numri i personave në bord do t’i komunikohet kapitenit të

anijes dhe do të raportohet te kapitenia e portit, si dhe tek institucionet e tjera përkatëse nëpërmjet pajisjeve ose sistemeve të përcaktuara në zbatim të legjislacionit në fuqi. Në rastet kur vendoset nga Administrata Detare Shqiptare, i komunikohet autoritetit të caktuar me anë të Sistemit Automatik të Identifikimit.

3. Kapitenia e Portit ndalon nisjen e anijes në rast të mos realizimit të detyrimeve sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 5

Informacioni mbi pasagjerët për udhëtime mbi 20 milje lundrimore

1. Kur një anije pasagjerësh niset nga një port shqiptar dhe ndërmerr një udhëtim me distancë mbi 20 milje lundrimore nga pika e nisjes për në portin tjetër të thirrjes, informacioni mbi pasagjerët në bord duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

a) mbiemrat e personave në bord, emrat e tyre, gjinia, kombësia e tyre, datat e tyre të lindjes;

b) informacionin, kur ofrohet bashkëpunim vullnetar nga një pasagjer, në lidhje me kujdesin ose ndihmën e veçantë që mund të nevojitet në rast emergjence, përfshirë edhe numrin e tij të kontaktit.

2. Informacioni i renditur në paragrafin 1 do të grumbullohet përpara nisjes së anijes së pasagjerëve dhe do të raportohet nëpërmjet pajisjeve ose sistemeve në zbatim të legjislacionit në fuqi jo më vonë se 15 minuta pas nisjes së tij.

3. Të dhënat personale të mbledhura për qëllimet e kësaj rregulloreje nuk do të përpunohen dhe nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër, por do të trajtohen gjithmonë në përputhje me ligjin nr. 120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

4. Në rast të mosrealizimit të detyrimeve sipas pikës 2 të këtij neni, Kapitenia e Portit nuk do lejojë nisjen e anijes.

Neni 6

Informacioni mbi pasagjerët për udhëtime mbi 20 milje lundrimore

1. Administrata Detare në lidhje me çdo anije pasagjerësh që mban flamurin e tij dhe niset nga një port që ndodhet jashtë Republikës së



Shqipërisë ose porteve të Shteteve të BE-së dhe është i destinuar për një port të vendosur brenda shteteve të BE-së, ose drejtë porteve të Republikës së Shqipërisë kërkon dhe sigurohet nga shoqëria që informacioni i specifikuar në pikën 1 të nenit 4 dhe në pikën 1 të nenit 5 është përcjellë siç parashikohet në pikën 2 të nenit 4 dhe në pikën 2 të nenit 5.

2. Administrata Detare, në lidhje me çdo anije pasagjerësh që mban flamurin e një vendi tjetër që nuk është vend i BE-s, niset nga një port që ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë ose Bashkimit Evropian dhe është i destinuar për në një port të vendosur në Shqipëri, kërkon dhe sigurohet nga shoqëria që informacioni i specifikuar në pikën 1 të nenit 4 dhe në pikën 1 të nenit 5 është dhënë në përputhje me pikën 2 të nenit 4 dhe me pikën 2 të nenit 5.

3. Kur sipas dispozitave përkatëse të Konventës SOLAS, Administrata Detare jep një përjashtim ose derogim në lidhje me informacionin për pasagjerët e një anijeje që mban flamurin e saj, që arrin në një port të vendosur brenda Komunitetit nga një port i vendosur jashtë Komunitetit, mund ta bëjë këtë vetëm sipas kushteve të përcaktuara në përjashtimet ose derogimet në këtë rregullore.

Neni 7

Detyrimet për sigurimin e informacionit mbi pasagjerët për udhëtime ndërkombëtare

Kapiteni i anijes pasagjere, përpara nisjes nga një port, duhet të sigurohet që numri i personave në bord të mos tejkalojë numrin e lejuar të përcaktuar në certifikatën respektive të anijes.

Neni 8

Detyrimet e shoqërive për menaxhimin e informacionit mbi pasagjerët

1. Çdo shoqëri që merr përgjegjësinë për operimin e një anije pasagjerësh, në zbatim të neneve 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, cakton një regjistruer pasagjerësh përgjegjës për raportimin e informacionit nëpërmjet pajisjeve ose sistemeve në zbatim të legjislacionit në fuqi ose nëpërmjet Sistemit Automatik të Identifikimit.

2. Të dhënat personale të mbledhura në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulloreje do të

mbahen nga shoqëria jo më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet e kësaj rregulloreje, dhe në çdo rast vetëm deri në momentin që lundrimi i anijes në fjalë ka përfunduar në mënyrë të sigurt dhe të dhënat janë raportuar në pajisjet ose sistemet në zbatim të legjislacionit në fuqi. Pa shkelur detyrime të tjera ligjore, duke përfshirë edhe ato statistikore, pasi informacioni nuk është më i nevojshëm për këtë qëllim, ai do të fshihet automatikisht dhe pa vonesa të panevojshme.

3. Çdo shoqëri duhet të sigurohet që informacioni, në lidhje me pasagjerët të cilët kanë deklaruar nevojën për kujdes të veçantë ose ndihmë në rast urgjence, të regjistrohet siç duhet dhe t'i jetë komunikuar kapitenit para se anija e pasagjerëve të niset.

Neni 9

Kufizimet dhe përjashtimet për informacionin mbi pasagjerët

1. Kur një anije pasagjerësh niset nga një port detar i Republikës së Shqipërisë, Administrata Detare Shqiptare mund të zvogëloj limitin e distancës të parashikuar në nenin 5.

2. Për çdo vendim për uljen e limitit të distancës për udhëtimet ndërmjet dy porteve në shtete të ndryshme anëtare të BE-së, do të merret një vendim i përbashkët midis këtyre dy shteteve.

3. Administrata detare shqiptare nga e cila një anije pasagjerësh niset mund ta lirojë atë nga detyrimi për të raportuar numrin e personave në bord në pajisjet ose sistemet në zbatim të legjislacionit në fuqi me kusht që anija në fjalë të mos jetë një mjet me shpejtësi të lartë, dhe të kryejë shërbime të rregullta në një kohë udhëtimi më pak se një orë midis ndalesave në porte ekskluzivisht deri në zonën detare në 3 milje dhe të sigurohet afërsia e faciliteteve për kërkim dhe shpëtim në atë zonë detare.

4. Në rrethanat e përcaktuara në paragrafin 3, do të aplikohet procedura e mëposhtme:

a) Administrata Detare Shqiptare do të njoftojë menjëherë Komisionin për vendimin e tij për të dhënë një përjashtim nga detyrimet e përcaktuara në nenin 5, duke dhënë arsyet thelbësore për këtë vendim. Ky njoftim do të kryhet përmes një baze të dhënash të krijuara dhe të mbajtura nga Komisioni për këtë qëllim, të cilës Komisioni dhe Shtetet Anëtare do të kenë qasje. Komisioni do të



bëjë të disponueshme masat e miratuara në një faqe interneti të qasshme publikisht.

5. Për shërbimet e rregullta në një zonë ku probabiliteti vjetor i dallgëzimit me lartësi mbi dy metra është më pak se 10%, dhe kur udhëtimi nuk i kalon afërsisht tridhjetë milje nga pika e nisjes, ose kur qëllimi kryesor i shërbimit është ofrimi i lidhjeve të rregullta për komunitetet e largëta për qëllime të zakonshme, Administrata Detare mund të kërkojë nga Komisioni Evropian, nëse konsideron se është e papërshtatshme për kompanitë të regjistrojnë informacionin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 5, që të përjashtohen, tërësisht ose pjesërisht, nga ky detyrim. Për këtë qëllim, duhet të ofrohen prova për papërshtatshmërinë dhe të dëshmohet se në zonën ku operojnë këto anije, ofrohet udhëzim navigimi nga toka dhe parashikime të besueshme të motit, si dhe ekzistojnë mjete të mjaftueshme dhe adekuate për kërkim-shpëtim.

6. Përjashtimet e miratuara nuk duhet të kenë asnjë efekt negativ mbi konkurrencën. Kërkesa duhet të paraqitet në Komision përmes bazës së të dhënave të përmendur në paragrafin 4. Nëse brenda 6 muajve nga paraqitja e kësaj kërkesë Komisioni vlerëson se përjashtimi nuk është i justifikuar ose mund të ketë pasoja negative për konkurrencën, Komisioni mund të miratojë akte zbatuese, duke kërkuar nga Administrata Detare të ndryshojë ose të mos miratojë vendimin e propozuar. Këto akte zbatuese do të miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në pikën 2 të nenit 13.

7. Administrata Detare Shqiptare, për anijet që kryejnë lundrime të brendshme ose në portet e një shteti anëtarë me të cilët mund të ketë një marrëveshje biletarale ku përfshihen kërkesat e kësaj rregulloreje, mund të kërkojnë nga Komisioni nëse e konsiderojnë jopraktike për shoqëritë, që të regjistrojnë informacionin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 5, të përjashtohen, plotësisht ose pjesërisht, nga ky detyrim. Për këtë arsye, duhet të sigurohen prova që dëshmojnë pamundësinë. Për më tepër, duhet të tregohet se në zonën ku operojnë këto anije, sigurohen udhëzime navigimi nga toka dhe parashikimet e besueshme të motit, si dhe janë të disponueshme mjetet e mjaftueshme dhe të përshtatshme për kërkim-shpëtim. Përjashtimet e dhëna në kuadër

të këtij paragrafi nuk duhet të kenë ndonjë efekt negativ në konkurrencë.

8. Kërkesa duhet të dërgohet te Komisioni përmes bazës së të dhënave të përmendura në paragrafin 3. Nëse brenda 6 muajve nga një kërkesë e tillë Komisioni konsideron se përjashtimi nuk është i justifikuar ose mund të ketë efekte negative në konkurrencë, Komisioni mund të miratojë akte zbatimi që kërkojnë nga Administrata Detare Shqiptare të ndryshojë ose të mos miratojë vendimin e propozuar. Këto akte zbatimi do të miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në pikën 2 të nenit 13.

9. Administrata Detare Shqiptare nuk do të përjashtojë ose japë derogimin ndaj asnjë anije pasagjere që lundron nga portet e Republikës së Shqipërisë dhe mban flamurin e një vendi të tretë, i cili është shtet anëtar i Konventës SOLAS dhe që sipas dispozitave përkatëse të SOLAS-it nuk është dakord me zbatimin e këtyre përjashtimeve.

Neni 10

Monitorimi dhe menaxhimi i të dhënave mbi pasagjerët

1. Administrata Detare Shqiptare duhet të sigurohet që shoqëritë kanë procedura për regjistrimin e të dhënave të pasagjerëve, e cila garanton që informacioni i kërkuar sipas kësaj rregullore të raportohet në mënyrë të përshtatshme dhe në kohën e duhur.

2. Administrata Detare Shqiptare është autoriteti përgjegjës për monitorimin e përmbushjes së standardeve të regjistrimit dhe raportimit të numrit të pasagjerëve nga shoqëria në zbatim të kësaj rregullore. Administrata Detare Shqiptare do të sigurojë që, në rast emergjence ose pas një aksidenti, të ketë akses të menjëhershëm në informacionin e kërkuar nga kjo rregullore.

3. Të dhënat personale të mbledhura në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulloreje do të ruhen nga Administrata Detare Shqiptare për një periudhë që nuk është më e gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet e kësaj rregullore, dhe në çdo rast, jo më gjatë se:

a) deri në momentin kur udhëtimi i anijes në fjalë të ketë përfunduar në mënyrë të sigurt, por në çdo rast jo më gjatë se 60 ditë pas nisjes së anijes; ose



b) në rast emergjence ose pas një aksidenti, deri në përfundimin e çdo hetimi ose procedurash gjyqësore.

4. Pa cenuar detyrimet e legjislacionit kombëtar ose ndërkombëtar në rastet kur Shqipëria ka detyrimin për ta zbatuar pasi informacioni të mos jetë më i nevojshëm, ai do të fshihet automatikisht dhe pa vonesa.

Neni 11

Mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave mbi pasagjerët

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, të dhënat e kërkuara duhet të mblidhen dhe të regjistrohen në një mënyrë që të mos shkaktojnë vonesa të panevojshme për pasagjerët që hipin ose zbresin nga anija. Përpunimi i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me ligjin nr. 120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

2. Mbledhja e të dhënave disa herë për rrugë të njëjta ose të ngjashme duhet të shmanget.

VENDIM

Nr. 122, datë 27. 11.2024

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “GRANTE PËR START UP-et DHE LEHTËSUESIT E START UP-eve PËR VITIN 2025”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z. Blendi Gonxhja	kryetar;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Brikena Qela	anëtare;
Znj. Keida Qirko	anëtare;
Z. Ahmet Mançellari	anëtar;

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 27.11.2024, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’” mori në shqyrtim njoftimin e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve të planit të ndihmës shtetërore për thirrjen për grante dhe masa mbështetëse për startupe dhe lehtësues.

I. Procedura

1. Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve me shkresën nr. 147, datë 25.11.2024, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në bazë të VKM-së nr. 61, datë 7.2.2024, “Për miratimin e kërkesave e të kritereve që duhet të plotësojnë start up-et dhe lehtësuesit e start up-eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblymit të anëtarëve të tyre”.

II. Përshkrimi i masës

2. *Objektivi:* plani i ndihmës synon mbështetjen e startup-eve dhe lehtësuesve për zhvillimin e startup-eve shqiptare në funksion të zhvillimit të vendit dhe përparimit në fushat prioritare. Ky program do të stimulojë sipërmarrjen inovative dhe njërive mbështetëse, duke ofruar financim dhe mbështetje për kompanitë startup më premtuese shqiptare, ofrimin e mbështetjes me grante të startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve.

3. *Baza ligjore:* plani i ndihmës shtetërore mbështetet në aktet ligjore si vijon:

- VKM nr. 61, datë 7.2.2024, “Për miratimin e kërkesave e të kritereve që duhet të plotësojnë start up-et dhe lehtësuesit e start up-eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblymit të anëtarëve të tyre”.

- Ligji nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, i ndryshuar.

- VKM nr. 664, datë 24.10.2024, “Për miratimin e projektligjit ‘Për buxhetin e vitit 2025’”.

4. *Kohëzgjatja:* plani i ndihmës do të zbatohet Planin i ndihmës do të zbatohet brenda vitit 2025.

5. *Dhënësi i ndihmës* është ministri përgjegjës për sipërmarrjen. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve.

6. *Përfutjesit:* përfitojnë mbështetje me grant do të jenë ndërmarrjet start up dhe lehtësuesit e start up-eve të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik të start up-eve dhe lehtësuesve, që janë të pajisur me pasaportën përkatëse.

7. *Shtrirja territoriale:* projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.



8. *Forma dhe vlera e ndihmës*: vlera e ndihmës shtetërore për vitin 2025 është 300.000.000 (tre qind milionë) lekë në formën e grantit të drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit nga fondet e miratuara për ministrin përgjegjës për sipërmarrjen. Numri i përfituesve të skemës do të jetë 51-100 përfitues.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të paragrafit 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, e cila ka një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfutur në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdoq formë e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Gjithashtu neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë² përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Skema e njoftuar mundëson mbështetjen me burime shtetërore, për një numër të kufizuar të ndërmarrjeve në treg, të cilat do të duhej t'i përballonin vetë në kushte normale të tregut. Për rrjedhojë, ndihma shtetërore forcon pozitën e ndërmarrjeve në raport me konkurrentët e tyre dhe për këtë arsye ka efekt shtrembërues potencial në konkurrencë. Skema e ndihmës shtetërore mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore.

Në këto kushte Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me shkronjën “c”, të nenit 13, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, ku parashikohet se ndihma shtetërore mund të lejohet nëse “*lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë*”. Komisioni vlerëson se rezultatet e skemës së ndihmës do të jenë pozitive, bazuar në njoftimin e ndihmës, sepse skema mundëson krijimin e një klime të favorshme për krijimin e startup-eve të reja, aftësimin dhe rrjetëzimin e themeluesve shqiptarë duke sjellë edhe përfshirjen dhe mbajtjen e talentit dhe burimeve njerëzore, rritjen e punësimit, lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare, nxitjen dhe futjen e inovacionit në sektorët ekonomikë.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është ndihmë shtetërore, e cila është e lejueshme në bazë të shkronjës “c”, të nenit 13, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, që përcakton se ndihma shtetërore mund të lejohet, nëse: “*lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë*”.

² Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Faqe | 24894

Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI :

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit për mbështetjen e start up-ve dhe lehtësuesit e start up-eve, të parashikuar në VKM-në nr. 664, datë 24.10.2024, “Për miratimin e projektligjit ‘Për buxhetin e vitit 2025’”.

2. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës “*De-minimis*” dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve.

3. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen nëpërmjet Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen nëpërmjet Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve të njoftojë çdo ndryshim të planit të ndihmës.

5. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve të ruajë deri në dhjetë vjet të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim të botohet në fletoren zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Blendi Gonxhja

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Brikena Qela, Keida Qirko, Ahmet Mançellari

VENDIM

Nr. 240, datë 14.11.2024

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN TETOR 2024 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2024/5 prot., datë 12.11.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin tetor 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- FSHU sh.a., me shkresën nr. 6978 prot., datë 5.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 2361 prot., datë 7.11.2024, ka depozituar në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin tetor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin tetor 2024 shoqëria FSHU sh.a. e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

- Për përlllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), FSHU sh.a. është bazuar në blerjet ditore/mujore të saj në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për muajin tetor 2024, profilet ditore të prokuruar në Bursë, çmimin ditor/orar si dhe vlerën e faturës ditore.



- ERE nëpërmjet postës elektronike më datë 7.10.2024 i kërkoi shoqërisë FSHU sh.a. për efekt të vlerësimit dhe transparencës së procedurës për përlogaritjes e kostos mesatare të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) nga FSHU sh.a. në rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, të paraqesë faturat e muajit shtator 2024 të energjisë elektrike të prokuruar në Bursën Shqiptare të Energjisë. Shoqëria FSHU sh.a. përcolli dokumentacionin e kërkuar në formatin Excel me shkresën protokolluar në ERE me nr. 2024/4 prot., datë 14.10.2024, duke përfshirë bashkëlidhur, faturat e blerjes së energjisë elektrike për muajin shtator 2024, tabelat përmbledhëse ditore dhe tabelat e përlogaritjes në lidhje me aplikimin mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët 35 kV për muajin shtator 2024.

- Pas shqyrtimit të materialeve të përcjella, me anë të shkresës nr. 2024/4 prot., datë 11.11.2024 nga shoqëria FSHU sh.a. u evidentuan se:

- Ekzistojnë diferenca të konsiderueshme mes çmimeve orare të blerjes së energjisë në tregun e ALPEX për muajin shtator 2024 si dhe rezultueseve të çmimeve mesatare të ponderuara ditore me çmimet orare dhe kostot mesatare të ponderuara ditore të paraqitura në aplikimin për miratimin e çmimit FMF 35 kV të muajit shtator 2024.

- Referuar të dhënave mbi sasi të nominuara të energjisë elektrike në bazë orare për nivelin e tensionit 35 kV u evidentuan vlera të pandryshuara ndërkohë që, për vlerat e sasive të nominuara të energjisë elektrike për nivelin e tensionit 20/10/6 kV u konstatua volatilitet përgjatë orëve të një dite. Gjithashtu, u kërkua paraqitja e arsyetimeve dhe e komunikimeve të zhvilluara mes FSHU sh.a. dhe ALPEX sh.a. në kuadër të sasisë së nominuar në bazë orare për muajin shtator 2024, për nivelin e tensionit 35 kV.

- Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) i përlogaritur nga shoqëria për muajin tetor 2024 është 10.42 lekë/kWh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rillogaritja e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së

energjisë elektrike është 10.42 lekë/kWh, sikurse pasqyruar edhe në përlogaritjet e përcjella nga vetë shoqëria.

- Referuar aplikimit të shoqërisë FSHU sh.a., rezulton se është marrë në konsideratë kursi ditor i këmbimit (euro/lekë), vlera të cilat janë bazuar në kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë për periudhën kohore 30.9.2024–30.10.2024.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2024 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** e cila për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV**, e cila mbështetur në vendimin të Bordit të ERE-s nr. 365, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.

- **Kostot administrative**, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, vijnë të jenë 1.06 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2024, përlogaritet si më poshtë:



<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin tetor 2024</i>			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	10.42
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.31
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRr+ TSHt+CA		Lekë/kWh	14.19

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton, se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë **14.19 lekë/kWh për muajin tetor 2024**.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin **tetor 2024 prej 14.19 lekësh/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV**.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 242, datë 14.11.2024

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “REBESOL” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 91, pika 1, dhe 92, pika 2 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1855/12, datë 13.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Rebesol’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Rebesol” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855 prot., datë 2.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, datë 12.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.9.2024 dhe 14.9.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 24.9.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për



fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Ndërsa me shkresën nr. 1927 prot., datë 16.9.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë (ku me shkresën nr. 1855/3 prot., datë 30.9.2024, ERE e ka njoftuar atë për vendimin nr. 184/2024 dhe i ka evidentuar informacionin / dokumentacionin e të munguar të këtij aplikimi) dhe shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/5 prot., datë 11.10.2024, ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj me vendimin e bordit të ERE-s nr. 218, datë 16.10.2024, është vendosur zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit me 30 (tridhjetë) ditë.

- Shoqëria në lidhje me plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar të aplikimit, ka kthyer përgjigje me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1855/8 prot., datë 11.12.2024 dhe nr. 1855/12 prot., datë 13.11.2024.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se shoqëria ka dokumentuar në kryerjen e aplikimit për pajisje me VNM-në paraprake të re në datën 6.11.2024. Gjithashtu, rezulton se nevojitet të sqarohet më tej me shoqërinë dokumentacioni takues që duhet të depozitohet për vlerën e mbetur të investimit të projektit.

- Në nenin 91, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet si vijon: “Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.” Në lidhje me zgjatjen e afateve procedurale të një procedure administrative, në nenin 92, pika 2 e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon si vijon: “Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”

- Për sa më lart, vlerësojmë se në rrethanat e një aplikimi të ri për VNM dhe pritjes së miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), si dhe për të sqaruar dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim, vlerësojmë zgjatjen deri më 26.1.2025 të afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “REBESOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë

elektrike, duke filluar ky afat nga data e aplikimit të shoqërisë për VNM-në paraprake, në datën 6.11.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri më datë 26.1.2025 të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Rebesol” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE VNM-në paraprake të re dhe dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare deri më datë 16.1.2025.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Rebesol” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 243, datë 14.11.2024

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË
BORDIT PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “SAMASOL” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 91, pika 1, dhe 92, pika 2 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1855/13, datë 13.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Samasol’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Samasol” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1854 prot., datë



12.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 185, datë 12.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.9.2024 dhe 14.9.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 24.9.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1927, datë 16.9.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Me shkresën nr. 1854/3 prot., datë 30.9.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i evidentuar informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë (ku me shkresën nr. 1854/3 prot., datë 30.9.2024, ERE e ka njoftuar atë për vendimin nr. 18.5.2024 dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin e të munguar të këtij aplikimi) dhe shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1854/5 prot., datë 11.10.2024, ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj me vendimin e bordit të ERE-s nr. 217, datë 16.10.2024, është vendosur zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit me 30 (tridhjetë) ditë.

- Shoqëria në lidhje me plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar për aplikimin, ka kthyer përgjigje me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1854/10 prot., datë 11.11.2024 dhe nr. 1854/12 prot., datë 13.11.2024.

- Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se shoqëria ka dokumentuar kryerjen e aplikimit për pajisje me VNM paraprahe të re në datën 7.11.2024. Gjithashtu, rezulton se nevojitet të sqarohet me tej me shoqërinë dokumentacioni takues, që duhet të depozitohet për vlerën e mbetur të investimit të projektit.

- Në nenin 91, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë”, parashikohet si vijon: “Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.” Në lidhje me zgjatjen e afateve procedurale të një procedure administrative, në nenin 92, pika 2 e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon si vijon: “Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”

- Për sa më lart, vlerësojmë se në rrethanat e një aplikimi të ri për VNM dhe pritjes së miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), si dhe për të sqaruar dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim, vlerësojmë zgjatjen deri më datë 27.1.2025 të afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Samasol” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke filluar ky afat nga data e aplikimit të shoqërisë për VNM-në paraprahe, më datë 7.11.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri më datë 27.1.2025 afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Samasol” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE VNM-në paraprahe të re dhe dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare deri më datë 17.1.2025.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Samasol” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 244, datë 14.11.2024

**MBI ZGJATJEN E VENDIMARRJES
SË BORDIT PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “ZENINA” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 91, pika 1, dhe 92, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1844/11, datë 13.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Zenina’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Zenina” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1844 prot., datë 30.8.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 186, datë 12.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.9.2024 dhe 14.9.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 24.9.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1927, datë 16.9.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë (ku me shkresën nr. 1844/4 prot., datë 30.9.2024, ERE e ka njoftuar atë për vendimin nr. 186/2024 dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin e të munguar të këtij aplikimi dhe

shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues), me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1844/5 prot., datë 9.10.2024, ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 14.10.2024, është vendosur zgjatja e afatit të vendimarrjes së Bordit me 30 (tridhjetë) ditë.

- Shoqëria në lidhje me plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar për këtë aplikim, ka kthyer përgjigje me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1844/8 prot., datë 11.11.2024 dhe nr. 1844/10 prot., datë 13.11.2024.

- Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se shoqëria ka dokumentuar kryerjen e aplikimit për pajisje me VNM Paraprake të re më datë 6.11.2024. Gjithashtu, rezulton se nevojitet të sqarohet me tej me shoqërinë dokumentacioni takues që duhet të depozitohet për vlerën e mbetur të investimit të projektit.

- Në nenin 91, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet si vijon: *Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë. Në lidhje me zgjatjen e afateve procedurale të një procedure administrative, në nenin 92, pika 2, e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon si vijon: Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.*

- Për sa më lart, vlerësojmë se në rrethanat e një aplikimi të ri për VNM-në dhe pritjes së miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), si dhe për të sqaruar dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim, vlerësojmë zgjatjen deri më datë 26.1.2025 të afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Zenina” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke filluar ky afat nga data e aplikimit të shoqërisë për VNM-në paraprake, më datë 6.11.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri më datë 26.1.2025 afatin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e



shoqërisë “Zenina” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE, VNM paraprake të re dhe dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare deri më datë 16.1.2025.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Zenina” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 245, datë 14.11.2024

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES
SË BORDIT PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “DRIBEN” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 91, pika 1, dhe 92, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1857/13, datë 13.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Driben’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Driben” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857 prot., datë 3.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 187, datë 12.9.2024, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Driben” sh.p.k., për arsye se shoqëria nuk kishte kryer pagesën e aplikimit sipas

përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Pas përmbushjes së detyrimit për kryerjen e pagesës nga ana e shoqërisë brenda afateve të përcaktuara në rregullore, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 203, datë 27.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2024 dhe 2.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 2057, datë 8.10.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë (ku me shkresën nr. 1857/6 prot., datë 4.10.2024, ERE e ka njoftuar atë për vendimin nr. 203/2024 dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin e të munguar të këtij aplikimi) dhe shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857/7 prot., datë 11.10.2024 ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 232, datë 30.10.2024, është vendosur zgjatja e afatit të vendimarrjes së Bordit me 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

- Me shkresën me nr. 1857/9 prot., datë 1.11.2024 dhe e-mailin e datës 1.11.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë mbi vendimarrjen e Bordit për zgjatjen e afatit dhe për sa mbetet ende pa plotësuar për aplikimin e saj. Me e-mailin e datës 12.11.2024, ERE ka rikujtuar shoqërinë për të depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.

- Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se shoqëria ka dokumentuar kryerjen e aplikimit për pajisje me VNM paraprake të re në datën 1.10.2024. Gjithashtu, rezulton se nevojitet të sqarohet më tej me shoqërinë dokumentacioni takues që duhet të depozitohet për vlerën e mbetur të investimit të projektit.



- Në nenin 91, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet si vijon: *Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.* Në lidhje me zgjatjen e afateve procedurale të një procedure administrative, në nenin 92, pika 2, e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon si vijon: *Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.*

- Për sa më lart, vlerësojmë se në rrethanat e një aplikimi të ri për VNM dhe pritjes së miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), si dhe për të sqaruar dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim, vlerësojmë zgjatjen deri më datë 21.12.2024 të afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Driben” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke filluar ky afat nga data e aplikimit të shoqërisë për VNM-në paraprake, më datë 1.10.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri më datë 21.12.2024 afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Driben” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE VNM-në paraprake të re dhe dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare deri më datë 11.12.2024.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Driben” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petril Ahmeti

KËRKESË

Nr. 1052/9, datë 17.12.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 414, datë 27.5.2020, për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga projekti, “Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës””.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “arë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 3,325,812 (tre milionë e treqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE TË NGURTA TE RAJONIT TË VLORES”

SHITESË E VKM-së nr. 414/2020																											
NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM													SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
														AR''			TRUALL			NDËRTESE			Vlerat e kultura bujqësore dhe dru-frutorëve, sipas proces- verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë		VLERA TOTALE (lekë)		
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërrësi (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Vlera e kulturës bujqësore (lekë)	Vlera e dru-frutorëve (lekë)			
	A	B	C	C	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	Y	Z	
1	NOVRUZ	SHABAN	ISUFAJ	KANINE	2074	645/10	ARE	6500	6500			4	60	862.0	204	175848			0			0		0	175848	Nga kufiri i projektit preket 862 m² nga 6500 m²	
2	AVERON	REIT	ZYBERAJ	KANINE	2074	645/60	ARE	3400	3400			4	110	3400.0	204	693600			0			0		0	693600		
3	KIMET	BATJAR	HOXHAI	KANINE	2074	645/67	ARE	1600	1600			4	118	1600.0	204	326400			0			0		0	326400		
4	VALBONA DEFRIM DELI FATOS BLENDAR NEXHIP VIKTORI GERANTINE	ELHAM ELHAM ELHAM ELHAM ELHAM BEKTASHI	TORO TORO TORO TORO TORO TORO	KANINE	2074	645/94	ARE	6400	6400			4	145	6400.0	204	1305600			0			0		0	1305600	Ne kartelën e pasurisë së paluajtshme emri i bashkëpronarit Nexhip Toro është shkruar Nexhip Toro	
5	AGIM	MUAMET	VELAJ	KANINE	2074	645/71	ARE	5600	5600			4	122	3870.0	204	789480			0			0		0	789480	.Ne seksionin D- Kufizimet e pronësisë është shënim i nr. regjistrimi 1.N.03.2000, datë regjistrimi 10.5.2000, të dhënat e aktit. Kjo pasuri është okupuar nga z. Mujsi Fejzaj . Nga kufiri i projektit preket 3870 m² nga 5600 m²	
6	AGIM	MUAMET	VELAJ	KANINE	2074	645/72	ARE	800	800			4	123	171.0	204	34884			0			0		0	34884	Nga kufiri i projektit preket 171 m² nga 800 m²	
													SHUMA			3325812			0			0		0	3325812		
																3325812			0			0		0	3325812		

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë

